



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.27.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
LEPOSAVIQIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Leposaviqit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Xhevat Seferi – Udhëheqës i Ekipit dhe Anëtarët: Stana Dançetoviq dhe Nebojsha Ristiq, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zukë Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
5 Qeverisja e mirë.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	28
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	30
Shtojca III: Letër konfirmimi	39

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Leposaviqit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23.11.2017. Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale përveç pagesave të parregullta nga investimet kapitale për furnizime dhe punë të pa pranuar në vlerë 175,298€, si dhe pagesave të dyfishta në vlerë 86,000€. Këto pagesa të parregullta në vlerën të përgjithshme prej 261,298€ janë çështje materiale dhe kanë ndikuar në opinion të kualifikuar të auditorit.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Vlera e obligimeve të shpalosura në pasqyrat financiare vjetore ishte nënvlerësuar për 94,778€;
- Vlera e pasurive jo financiare, e shpalosur në pasqyrat financiare vjetore nuk ishte e plotë dhe e saktë, pasi që pasuritë e blera dhe të trashëguara apo të pranuar nuk janë regjistruar; dhe
- Dosjet, përkatësisht kontratat e punës për së paku 32 punonjës të administratës komunale nuk janë azhurnuar.

Për më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës, për të përcaktuar se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Kapitujt e mëposhtëm ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në secilën fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë, me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Leposaviqit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Ne kemi kualifikuar opinionin e auditimit për faktin se:

- Për projektin "Furnizimi me pajisje për filtrimin e ujit në pishinat e qendrës sportive në Leposaviq" kemi vërejtur se tenderi është shpallur më 21.11.2016, jashtë afatit ligjor, të përcaktuar me Ligjin për Buxhet¹. Kontrata është nënshkruar më 20.12.2016 në vlerë 163,573€ me Operatorin ekonomik në konzorcium. Për më tepër, pagesa prej 163,573€ ishte kryer direkt me vendim të Thesarit, sipas nenit 39.2² të Ligjit Nr. 03/L-221 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi. Nga testimi jonë dhe ekzaminimi i mostrave në terren (datë 07.12.2017 dhe 17.04.2018) kemi vërejtur se Pajisjet për pishinën olimpikë nuk ishin furnizuar dhe instaluar, ndërsa në raportin e organit mbikëqyrës të projektit të nënshkruar më 22.12.2016 është raportuar se pajisjet janë pranuar në përputhje me specifikimet e kërkuara;
- Për projektin "Furnizim me 90 kontejnerë për mbeturina për nevojat e ndërmarrjes publike-JKP Leposaviq, në vlerë prej 13,075€ (komplet vlere e paguar), sasia e pranuar e kontejnerëve ishte vetëm për nëntë copë në vlerë 1,350€, ndërsa 81 kontejnerë tjerë në vlerë 11,725€ komuna nuk i ka pranuar dhe nuk i janë dorëzuar ndërmarrjes JKP Leposaviq;
- Për projektin "Rindërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Leshak - Bello Brdo në komunën e Leposaviqit", Fatura nr. 4/2/2016 e datës 11.02.2016 në vlerë prej 76,000€ (me përshkrimin situacioni VI punët e kryera në rrugët Leshak-Belo Brdo), ishte paguar me vendim të Thesarit më datë 24.03.2017. Të njëjtën faturë prej 76,000€ e ka paguar prapë komuna më datë 11.04.2017; dhe
- Po ashtu, për projektin "Rindërtimi i rrugëve lokale në fshatrat e komunës së Leposaviqit", Fatura nr. 3/2/2016 e datës 11.02.2016 në vlerë prej 10,000 € (me përshkrimin situacioni V - punët e kryera në rrugët Soqanica -Pridvorica), ishte paguar me vendim të Thesarit më datë 24.03.2017. Të njëjtën faturë prej 10,000€ e ka paguar prapë komuna më datë 11.04.2017.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

¹ Ligji për Buxhet Nr. 05 / L-071, Neni 11, Pika 6 "Një Organizatë buxhetore nuk duhet të shpallë ftesë për tender për një projekt kapital të aprovuar, të identifikuar në Tabelën 3.2 dhe 4.2 pas datës 31 Tetorit 2016 për shpenzim potencial në vitin fiskal 2016, përveç nëse ato shpenzime janë planifikuar për vitin 2017, të specifikuar qartë në Tabelën 3.2 dhe 4.2.

² 39.2 Kur një person ka lëshuar një faturë ose kërkesë për pagim për një organizatë buxhetore dhe shuma në fjalë nuk është paguar për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë, personi në fjalë mundet ta dorëzojë një kopje të faturës ose kërkesës për pagim në Thesar. Pas pranimit të kopjes së faturës ose kërkesës për pagim, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, brenda tridhjetë (30) ditëve të ardhshme, do të bëjë një hetim në organizatën buxhetore për të vërtetuar nëse (i) fatura ose kërkesa për pagim është e vlefshme dhe se mallrat dhe shërbimet janë furnizuar ose punët janë realizuar, dhe (ii) shuma përkatëse nuk është paguar nga organizata buxhetore për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë. Nëse rezultati i hetimit del të jetë pozitiv, Thesari do e paguan shumën në fjalë pa pasur nevojë të marrë miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore. Në raste të këtilla, Thesari është i autorizuar që ekzekutojë një njoftim për bartjen e shpenzimit pa miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna nuk ka ndërmarrë masa lidhur me menaxhimin e pasurive të blera dhe të trashëguara në vitet e mëparshme. Më tutje, pasuritë e paraqitura në PFV për vitin 2017 nuk janë regjistruar në SIMFK, si dhe nuk është duke u përdorur sistemi e-pasuria për regjistrimin e pasurisë me vlerë nën 1,000€. Si pasojë nuk janë shpalosur vlerat e sakta dhe të plota të pasurive komunale, si dhe stoqet e materialit shpenzues në PFV;
- Kontratat e punës për 32 punonjës të komunës nuk janë azhurnuar. Në raportin për vitin 2016 ne kemi raportuar se së paku 65 të punësuar paguheshin me kontrata të pa azhurnuara. Komuna ka bërë aktemërimet të përhershme për 37 nga ta, në mënyrë selektive, ndërsa për pjesën tjetër ende nuk ka ndjekur procedurat e akt emërimit. Për më tepër, nuk është bërë vlerësim i performancës të punës së punonjësve të cilët kanë tanimë akt emërimet; dhe
- Vlera e obligimeve të shpalosura në PFV nuk është e saktë, sepse është shpalosur shuma prej 3,314,513€, ndërsa vlera e tyre sipas auditimit ishte 3,409,291€, me diferencë (nënvlerësim) për 94,778€. Përveç kësaj në PFV si obligim është paraqitur edhe shuma prej 197,101€ e cila ishte paguar në dhjetor nga Thesari në bazë të urdhërit të përmbaruesit privatë.

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se:

- Komuna nuk i posedon planet/strategjitë, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.;
- Sfidat në menaxhimin e personelit, mangësi në aprovimin e strukturës organizative si dhe kërkesat tjera që ndërlidhen me zbatimin UA-ve përkatëse;
- Komuna ende nuk ka vendosur politika të zbatimit të ligjit për Tatimin në pronë si dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e mjeteve nga kjo veprimtari. Po ashtu nuk ka inkasuar të hyra nga lejet e ndërtimit, apo për shfrytëzim të pronave/hapësirave komunale; dhe
- Niveli i lartë i obligimeve (mbi 3 mil.€) do të shkaktojë vështirësi buxhetore në vitet në vijim.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Leposaviqit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës gjithashtu është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës si dhe sigurimin e vendosjes dhe funksionimit të kontrolleve të brendshme, në mënyrë që të evitohen keqpërdorimet dhe mashtrimet e mundshme brenda organizatës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; raportet operative (të performancës); dhe

- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë.

Në kontekst të PFV-ve, çështjet në lidhje me kornizën raportuese, ishin adresuar me rastin e përgatitjes së draft Pasqyrave financiare.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë përveç çështjeve të paraqitura në opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur ne japim rekomandimet, si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari, duhet të siguroj se është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për kualifikimin e opinionit, theksimit të çështjes, si dhe të çështjeve kyçe të theksuara në këtë raport. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet në procesin e pagesave, në mënyrë që të evitohen pagesat e dyfishta apo edhe pagesat për të cilat punët/furnizimet dhe apo shërbimet nuk janë kryer. Për pagesat e dyfishta të sigurohet që brenda një periudhe të shkurtër pas pranimit të këtij raporti të kthehen në buxhetin e komunës, ndërsa për punët/furnizimet/shërbimet, të cilat nuk janë përfunduar të behet një komision i veçantë i cili do të monitoroj ketë proces deri në kompletimin e plotë të tyre, në të kundërtën mjetet financiare të kthehen në buxhetin komunal. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se janë regjistruar të gjitha objektet dhe pronat tjera të paluajtshme, si janë marrë të gjitha veprimet e duhura për të filluar aplikimin e tatimit në pronë dhe kompletimit të udhëzimeve rreth strukturës organizative.

Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me MFK-në, pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në komunë. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e shpenzimeve për investime kapitale, vazhdon të mbetet fushë sfiduese. Gjithashtu, në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi subvencionet dhe të hyrat në përgjithësi nuk janë të përshtatshme dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, menaxhimi i subvencioneve si dhe performanca e dobët në arkëtimin e të hyrave.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar ³	Buxheti Final ⁴	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	4,210,272	5,187,365	4,875,777	3,425,423	2,698,312
Granti i Qeverisë -Buxheti	4,012,259	4,156,559	4,089,406	3,156,956	1,838,789
Të hyrat vetjake ⁵	198,013	198,013	22,664	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim	-	570,595	517,032	-	-
Donacionet e jashtme	-	262,198	246,675	268,467	859,523

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 977,093€, dhe atë si rezultat i Fondit Zhvillimor në vlerë 570,595€ të bartura nga viti 2016, donacionet e jashtme në vlerë 262,198€, si dhe grandit qeveritar të aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë në shumën prej 144,300€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final, i cili është reflektuar nga pagesat direkte të cilat i ka ekzekutuar Thesari në vlerë prej 659,359€ si dhe pagesave përmes përmbarueseve ligjor

³ Buxheti fillestar - Buxheti i aprovuar nga kuvendi me Ligjin 05-L-125 për buxhetin 2017.

⁴ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

në vlerë 201,103€, ndonëse një pjesë e tyre kanë të bëjnë me pagesat për punët e papërfunduara. Realizimi i buxhetit vazhdon të mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Komuna për vitin 2017 kishte planifikuar 69 prokurime për furnizime, shërbime dhe kryerje të punëve. Të gjitha këto kanë rezultuar me nënshkrim të kontratave në vlerë të përgjithshme prej 516,622€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	4,210,272	5,187,365	4,875,777	3,425,423	2,698,312
Pagat dhe Mëditjet	2,012,088	2,128,772	2,123,298	1,008,206	931,273
Mallrat dhe Shërbimet	217,492	269,386	210,196	209,460	225,713
Shërbimet komunale	64,000	64,000	62,130	2,257	44,698
Subvencionet dhe Transferet	69,973	94,923	94,220	69,770	78,000
Investimet Kapitale	1,846,719	2,630,284	2,385,933	2,135,730	1,418,628

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për shpenzime kapitale me buxhetin final ishte për 783,565€, si rezultat i bartjes së mjeteve të Fondit zhvillimor nga viti 2016 si dhe donacioneve të jashtme. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga vitet e kaluara dhe projektet të reja për vitin aktual. Megjithëqë, buxheti për këtë kategori ishte realizuar 91%, e cila është ndikuar nga pagesat direkte nga Thesari si pasojë e hyrjes në obligime në fund të vitit 2016;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 116,684€, ishte si rezultat i pagesës së pagave për punëtorët në sektorin e arsimit dhe atij të shëndetësisë, të cilët dy vite më parë ishin ndaluar pagat si rezultat i një vendimi politik, si dhe rekrutimit të punonjësve në sektorin e arsimit dhe atë të shëndetësisë. Njëkohësisht, kjo ka bërë që shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte për 1,115,092€ më i lartë se sa në vitin 2016; dhe
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime për 51,894€ përfshin grandin qeveritar dhe gjithashtu të hyrat vetjake të komunës.

Çështja 2 - Realizimi i dobët i buxhetit dhe pagesat direkte nga Thesari

E gjetura Realizimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur. Një pjesë e madhe e shpenzimeve janë paguar përmes pagesave direkte nga Thesari me vendim sipas nenit 39.2 të LMFP (659,359€) dhe një pjesë ishte paguar me vendim përmes përmbaruesit ligjor (201,103€), si rezultat i mos pagesës së faturave me kohë. Kjo ka ndodhur për shkak të një planifikimi të dobët dhe të pabazuar në objektiva të qarta, si dhe hyrja në obligime përmes kontratave kornizë pa pasur mjete të buxhetuara. Kjo performancë e dobët buxhetore kishte të bënte kryesisht me investimet kapitale. Në anën tjetër si rezultat i mos menaxhimit të duhur të kontratave për investime kapitale, komuna ka ngelur me obligime prej 3,406,722€, që janë edhe obligime nga viti 2016 dhe të cilat nuk ishin shpalosur dhe raportuar si obligime në PFV të vitit 2016. Këto obligime do ta vënë në vështirësi komunën për vitin 2018 dhe në vitet në vijim.

Planifikimi i të hyrave mund të jetë mbivlerësuar, përderisa arkëtimi dhe shfrytëzimi i tyre është shumë i ulët dhe ka një performancë shumë të dobët. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna vazhdon të mos zbatoj Ligjin për tatimin në pronë dhe ligjin për ndërtimet, por edhe jo seriozitet dhe neglizhencë në arkëtimin e të hyrave (shih nënkaptullin 3.2).

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i tij jo në përputhje me Ligjin për buxhet dhe LMFP, do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës, shërbime dhe infrastrukturë të dobëta për qytetarë si dhe humbjen e kredibilitetit ndaj qytetarëve dhe donatorëve potencial. Ndërsa, rritja e obligimeve në nivelin shumë të lartë rritë rrezikun që komuna të jetë në kolaps financiar dhe të vë në rrezik funksionimin e komunës.

Rekomandimi 2 Kryetari, duhet të siguroj që performanca buxhetore të monitorohet vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson pengesat dhe vështirësitë për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurohet që të kontrollohet në mënyrë rigorozë menaxhimi i kontratave për investime kapitale dhe të kërkoj përgjegjësi nga menaxherët dhe organi mbikëqyrës i projekteve.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2017 ishin në vlerë shumë të ulët vetëm 536€. Burimet e arkëtimit direkt të hyrave vetjake janë të kufizuara vetëm nga taksat për certifikata të gjendjes civile. Gjithashtu, komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet e policisë prej 24,808€ dhe gjobat e gjykatave në vlerë gjithsej 185€. Komuna, ende nuk është duke aplikuar kërkesat ligjore të ngarkesave për tatimin në pronë, lejet e ndërtimit, shfrytëzimin e pronave publike etj.

Shpjegimet për planifikimin dhe realizimin e arkëtimit të të hyrave janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	198,013	198,013	536	2,078	1,623
Gjithsej të hyrat vetjake	198,013	198,013	536	2,078	1,623

Komuna, kishte arritur që të inkasoj vetëm shumë simbolike të të hyrave të planifikuara. Krahasuar me vitin paraprak të hyrat kanë shënuar ulje të madhe, megjithëse edhe të hyrat e viteve të kaluara ishin të ulëta. Kjo situatë është si pasojë e mos aplikimit të procedurave për arkëtimin e të hyrave për tatimin në pronë, lejet e ndërtimit, shfrytëzimin e pronave publike apo burime tjera të të hyrave komunale. Lidhur me nivelin e dobët të arkëtimit të të hyrave ne kemi raportuar të çështjet kyçe të auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime tjera në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë: (a) Kontrolli i pagesave çdo muaj, përmes azhurnimit dhe nënshkrimit të listës së pagave, (b) Kontrollin e ndryshimeve të mundshme të cilat mund të paraqiten në formularë, (c) Shqyrtimin e buxhetit për atë kategori dhe harmonizimet me Thesarin. Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2017 ishte 2,128,772€, dhe prej tyre ishin shpenzuar 2,123,298€ apo 99% e buxhetit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i burimeve njerëzore ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve të organizatës për të siguruar funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe të kuvendit komunal, të cilat zbatohen në gjithë organizatën. Menaxhimi i BNj përfshinë: Hartimin dhe rishikimin e strukturës organizative, kategorizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, kontrollin e kostove buxhetore të personelit, si dhe kontrollin e procesit të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të personelit, duke përfshirë këtu edhe matjen e efektivitetit të personelit përmes vlerësimit të performancës së kryerjes së detyrave.

Çështja 3 - Sfidat në menaxhimin e personelit

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Menaxhmenti ende nuk ka miratuar një Rregullore të brendshme për strukturën organizative, sistematizim të vendeve të punës dhe harmonizimin e saj me nevojat dhe buxhetin e komunës. Kjo ka ndikuar që disa vende pune kyçe të mos plotësohen me staf adekuat. Komuna ende nuk ka njësi të personelit dhe nuk ka emëruar Menaxher të personelit. Megjithatë, komuna ka pasur një konkurs dhe ka punësuar disa zyrtarë në administratën komunale si dhe punonjës në arsim dhe shëndetësi. |
| Rreziku | Mungesa e strukturës organizative të personelit, nuk ofron siguri në organizimin e brendshëm të komunës, njëkohësisht në ndarjen e detyrave dhe përshtatshmërinë e vendeve të punës. |
| Rekomandimi 3 | Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për t'i adresuar në mënyrë urgjente çështjet e përmendura, ashtu që komuna të ketë të vendosur strukturën organizative, të funksionalizojë njësinë e personelit dhe të përzgjedh menaxherin e personelit në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues. |

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 269,386€, prej tyre ishin shpenzuar 210,196€ ose 78%, ndërsa shpenzimet komunale janë shpenzuar 97%. Këto mjete shpenzohen në furnizimin me pajisje dhe inventar, furnizime zyre, shërbime të kontraktuara, karburant, pajisje mjekësore, mirëmbajtje të ndërtesave të zyrave, telefonit etj.

Çështja 4 - Dobësi në menaxhimin e kontratave për shpenzime të derivateve

E gjetura Shpenzimet totale të derivateve për vitin 2017 ishte 57,789€ dhe përfaqësojnë më shumë se 21% të shpenzimeve totale për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Me rastin e furnizimeve me derivate, komuna, sipas kontratës duhej të monitorojë ndryshimet e çmimeve të naftës në bursat ndërkombëtare. Megjithatë, kjo nuk është bërë, ndonëse ka pasur ndryshime në çmimin e tregut, komuna gjithnjë është furnizuar me çmimin fiks për naftë prej 1.09€/L dhe për benzinë me çmim 1.10€/L.

Gjithashtu, duhet të përmendim faktin se komuna nuk mbanë shënime adekuate për shpenzimet për automjetet zyrtare, zyrtarët nuk paraqesin kërkesa për përdorimin e automjeteve dhe nuk përgatisin urdhëresat për udhëtim zyrtar.

Rreziku Pagesat pa u siguruar dëshmi të mjaftueshme për furnizimin me çmimin aktual, dhe mos mbajtja e një evidence adekuate të përdorimit të automjeteve zyrtare dhe kilometrave të kaluar, mund të ndikoj në pagesa të parregullta dhe rritë rrezikun për keqpërdorim të fondeve.

Rekomandimi 4 Kryetari, duhet të siguroj që çdo pagesë e realizuar është e dokumentuar dhe ekziston pranimi i atyre mallrave apo shërbimeve në bazë të çmimit përkatës dhe kushteve të përcaktuara me kontratë. Më tutje, kryetari duhet të siguroj se janë zbatuar rregulla të qarta për mënyrën e përdorimit të automjeteve dhe evidentimit të shpenzimeve.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti për Subvencione dhe transfere, ndahet kryesisht për entitete publike, entitete jo publike dhe përfitues individual. Shembuj të subvencioneve janë subvencionet për sport, ndihmë për rastet sociale, subvencione në bujqësi, etj.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në vitin 2017 ishte 94,923€, prej tyre ishin shpenzuar 94,220€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndihma për individë si raste sociale.

Çështja 5 – Ndarja e subvencioneve pa rregullore për subvencionim dhe pa kritere të qarta

E gjetura Menaxhmenti nuk ka hartuar dhe miratuar rregullore për mënyrën dhe kriteret e subvencionimit. Në mungesë të rregullores të gjitha subvencionet pa kufizim vlerash aprovohen me vendim të Kryetarit të Komunës dhe jo përmes miratimit nga Kuvendi Komunal. Më tej, është identifikuar se, komisioni për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim ka dhënë propozim për aprovimin e kërkesave për subvencione për të cilat nuk kishte kritere të qarta. Në anën tjetër, përfituesit e subvencioneve në asnjë rast nuk kanë dërguar raporte kthyesë për mënyrën e shfrytëzimit të atyre mjeteve, për të konfirmuar se subvencioni i dhënë është shpenzuar për qëllimin për të cilin është dedikuar.

Rreziku Mos aprovimi i rregullores së brendshme për dhënien e subvencioneve si dhe dështimi në monitorimin e subvencioneve, përkatësisht, mos raportimi i përfituesve, rritë rrezikun që subvencionet të mos ndahen për qëllime adekuate, pa kritere dhe në bazë të interesave të ndryshme, apo në mënyrën tjetër, në mos arritjen e qëllimit për të cilin janë dedikuar.

Rekomandimi 5 Kryetari, duhet të siguroj që do të hartoj dhe aprovoj në kuvend komunal një rregullore për subvencionet me të cilën do të përcaktoj kriteret e qarta për subvencionim, si dhe mekanizmat se si do të monitorohen dhe menaxhohen subvencionet. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale për vitin 2017 ishte 2,630,284€, prej tyre ishin shpenzuar 2,385,933€ ose 91% e buxhetit. Shpenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës në shëndetësi, arsim, si dhe infrastrukturë rrugore. Komuna, gjithashtu një pjesë të investimeve kapitale i ka shpenzuar edhe në zhvillimin ekonomik të komunës përmes Fondit për Zhvillim Ekonomik.

Çështja 6 - Dobësi në menaxhimin e kontratës për infrastrukturën rrugore

E gjetura Për kontratën "Ndërtimi i rrugëve lokale në qytet dhe fshatra të komunës së Leposaviqit" e nënshkruar në tetor 2015, komuna nuk kishte dorëzuar tek Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) Deklaratën për disponueshmërinë e fondeve për projektet e pa planifikuara buxhetore (kërkesë sipas LPP). Për më tepër në këtë rast nuk janë dhënë me kontratë paramasat dhe parallogaritë se sa njësi do të kryhen për secilin pozicion dhe nuk dihet kostoja e tërë projektit. Po ashtu, nuk ka as projekte konkrete sa rrugë do të ndërtohen, sa do të jetë gjatësia dhe gjerësia e tyre, çfarë materiali do të përdoret dhe sa do të kushtoj secili. Nuk ka as plan dinamik për asnjërin prej projekteve.

Komuna, nuk ka specifikuar projektet që do të zbatohen nga kjo kontratë, si dhe mënyrën se si do të sigurohen fondet⁶.

Rreziku Lidhja e kontratave kornizë afat gjate pa siguruar disponueshmërinë e fondeve, mund të ndikojnë që komuna të hyj në obligime të papërbalueshme buxhetore për vitet e ardhshme. Kjo mund të ndikoj edhe me realizim të dobët të kryerjes së punëve për shkak të mosekzistimit të një projekti, ku përcaktohet çdo detaj se çka do të ndërtohet, sa do të ndërtohet dhe me çfarë materiali. Këto projekte mund të rezultojnë me vlerë të dobët për parane dhe humbje buxhetore.

Rekomandimi 6 Kryetari, duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për gjetjet e auditimit për këto raste, ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse kanë ndodhur dështimet dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Më tutje, duhet të ketë parasysh vlerën për parane sidomos për projekte të kushtueshme kapitale, duke ndërmarrë masa për eliminimin e këtyre dobësive. Për ndërtimin e rrugëve dhe për projekte komplekse duhet të evitohen kontratat kornizë dhe të lidhen kontrata të veçanta për secilin projekt në veçanti.

⁶ Sipas Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04 / L-042, Neni 9.3 kërkohet që të përcaktohen të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate publike kornizë, si dhe mjetet e nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Çështja 7 - Pagesat për obligimet kontraktuale të pa përmbushura

E gjetura Për kontratën "Ndërtimi i rrugëve lokale në qytet dhe në fshatrat e Leposaviqit", nga Thesari është bërë pagesë direkte në vlerë totale prej 495,785€⁷. Në bazë të një letërkëmbimi nga Thesari, komuna kishte konfirmuar se nuk i kishte shlyer detyrimet e veta ndaj kontraktuesit pasi që nuk kishte siguruar fonde të mjaftueshme.

Më tutje, për disa projekte komuna kishte nënshkruar memorandume mirëkuptimi me Ministrinë e Kthimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë për financimin e projekteve. Me këto memorandume përcaktohej se projektet do të financoheshin nga këto ministri përkatëse dhe se ministrinë do të përcaktonin një përfaqësues për mbikëqyrjen e projekteve. Për të gjitha këto projekte organi mbikëqyrës ishte përfaqësuar vetëm nga ana e komunës (ministrinë nuk kanë emëruar përfaqësuesin e vet). Organi mbikëqyrës kishte përgatitur një raport, ku ka theksuar se punimet janë kryer. Me vendim të përmbaruesit privat më 26.10.2017, Thesari i kishte kryer pagesat direkte nga buxheti i Komunës në shumë prej 201,103€, nga e cila shuma prej 197,101€ për obligime të papaguar ndaj Operatorit Ekonomik (OE), ndërsa shuma prej 4,002€ i ishte paguar përmbaruesit për shërbimet e kryera edhe pse faturat i ishin lëshuar dy ministrive të përmendura dhe jo komunës. Nga vizita jonë në terren është vërejtur se furnizimi me pajisje për filtrim të ujit dhe montimi i tyre në pishinë nuk ishte kryer fare, ndërkohë që organi mbikëqyrës kishte raportuar se të gjitha punët janë kryer për këtë projekt.

Rreziku Pranimi i faturave pa u siguruar se të gjitha punët janë kryer sipas kërkesave me kontratë do të rezultojë në obligime pa u pranuar furnizimet/punët. Raportimi jo i saktë i organit mbikëqyrës do të rezultojë me mundësinë për pagesa të pa kontrolluara, pagesa të dyfishta dhe mundësi për keqpërdorim të parasë publike dhe pasurisë së komunës.

Rekomandimi 7 Kryetari, i komunës duhet të siguroj që memorandumet dhe marrëveshjet e nënshkruara me partner tjerë të zbatohen në përpikëri nga të dy palët në marrëveshje në mënyrë që të përmbushen të gjitha pikat e marrëveshjes. Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj mbikëqyrje rigoroze të kryerjes së detyrave të të gjithë akterëve të përfshirë në projekte të tilla, si dhe të kërkoj përgjegjësi nga organi mbikëqyrës dhe komisionet për pranimin teknik të punëve të kryera për të evituar mundësinë e keqpërdorimeve dhe mashtrimeve. Në situata kur vëren apo ka indikacione se ka dyshime për keqpërdorime dhe mashtrime, kryetari duhet të ndërmarrë veprime konkrete ligjore në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

⁷ Fatura e datës 22/11/2016 me numër 6/11 në vlerë prej 409,785€, fatura e datës 11/02/2016 me numër 3/2/2016 në shumën prej 10,000€; dhe fatura e datës 11/02/2016 me numër 4/2/2016 në vlerë prej 76,000€

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 8 - Nënshkrimi i kontratave pa procedura të prokurimit

E gjetura Për shërbime të eliminimit të ashtuquajturave “deponi të egra” të mbeturinave kryetari i komunës kishte anashkaluar procedurat e prokurimit dhe kishte nënshkruar kontratë me OE i cili nuk kishte për veprimtari biznesi menaxhimin e mbeturinave. Vlera totale e kontratës ishte 53,071€, pa u dhënë detaje se ku do të punohet, sa dhe me çfarë çmimi për njësi. Komuna nuk ka ofruar dëshmi për lokacionin se ku janë kryer ato punime. Shpenzimet e paguara për këtë kontratë ishin gjithsej 52,037€ prej të cilave pagesat në total prej 12,358€ nuk kishin të bënin me këtë kontratë. Përshkrimi në faturë për këto pagesa ishte: “Pagesë për shërbime të ujësjellësit, hapja e kanalit si dhe shtrirja e rërës për shërbimet komunale të ujësjellësit në mirëmbajtje të rrjetit”, punime të cila nuk ishin në përputhje me kontratën.

Për më tepër, Komuna ka të regjistruar një Ndërmarrje publike për menaxhimin e mbeturinave dhe nuk ka pasur nevojë të angazhojë një kompani tjetër për këto qëllime.

Po ashtu, për projektin "Mbështetje për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe zhvillimin e bujqësisë" vlera 149,980€, të financuar nga Bordi i Fondit të Zhvillimit, kryetari i komunës më 27.04.2017 ka nënshkruar kontrata me 142 përfitues bujqësor për blerjen e pajisjeve bujqësore. Për këtë projekt, nuk është zbatuar ndonjë procedurë e prokurimit. Për më tepër, përfituesit kanë sjellë faturat për pajisjet e blera, mirëpo komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të monitoruar apo verifikuar realizimin e projektit.

Rreziku Realizimi i projekteve pa procedura të prokurimit dhe mos monitorimi i zbatimit të tij, mund të çojë në favorizimin e përfituesve dhe mundësinë e pagesës së shpenzimeve me çmime më të larta se sa ato që do të realizoheshin përmes një konkurrence reale të tregut. Për shkak të kontrolleve të dobëta të brendshme mund të rezultojë me vlerë të dobët për paranë si dhe mundësinë për keqpërdorim dhe mashtrim.

Rekomandimi 8 Kryetari, duhet të sigurojë masa adekuate në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të projektit përmes procedurave të prokurimit, për të evituar favorizimin e përfituesve, në mënyrë që të arrihet zvogëlimi i kostove buxhetore dhe rritja e vlerës për paranë, si edhe evitimi i mundësive për keqpërdorim të parasë publike dhe pasurisë së komunës.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre, si dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Pasuritë kapitale janë të gjitha pasuritë në pronësi të komunës me kosto mbi 1,000€, ndërsa ato jo kapitale janë me vlerën nën 1,000€.

Dobësitë lidhur me menaxhimin e pasurive janë paraqitur te opinioni i auditimit si Theksim i çështjes (shih nënkaptullin 2.1).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandimet tjera në këtë fushë.

3.10 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta, janë fond i vogël i parave që mbahen në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.11 Të arkëtueshmet

Meqenëse, komuna nuk lëshon asnjë lloj fature për tatime dhe taksa, ajo nuk ka llogari të arkëtueshme dhe nuk mban evidenca për to. Taksa për lëshimin e certifikatave të ndryshme janë pagesa me para në dorë përmes arkës me rastin e dorëzimit të kërkesës për certifikatë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.12 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 të shpalosura në PVF-të e komunës për vitin 2017 ishte në shumën prej 3,314,513€.

Çështja 9 - Menaxhimi joadekuat i faturave të shpenzimeve dhe raportimi në PFV

- E gjetura** Sipas rregullës financiare nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, neni 24 Pranimi dhe pagesa e faturës, secila fature e pranuar duhet të protokollohet dhe evidentohet në librin e faturave, megjithatë, komuna nuk ka zbatuar kërkesën e përmendur, e cila ka rezultuar në një regjistër të pa azhurnuar të faturave të pa paguara.
- Rreziku** Kontrollat e pamjaftueshme financiare për obligimet e pa paguara të komunës dhe mos zbatimi i rregullave financiare mund të rezultojë me pagesa të paplanifikuara me buxhetin e ardhshëm të komunës dhe/apo pagesa të dyfishta. Kjo mund ta çoj komunën në vështirësi buxhetore dhe në dështim të arritjes së objektivave vjetore operative.
- Rekomandimi 9** Kryetari, duhet të forcoj kontrollat lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Komuna ka pranuar raportin tonë të auditimit për vitin 2016 në qershor 2017, dhe është zotuar se do të zbatojë të gjitha rekomandimet. Mirëpo, ata nuk kanë respektuar as afatin kohor për përgatitjen e planit të veprimit brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit. Ky plan ishte përgatitur me 109 ditë vonesë.

Raporti i auditimit nuk ishte diskutuar në Kuvendin Komunal, ashtu siç është rekomanduar në raportin e vitit të kaluar.

Nga 16 rekomandimet e dhëna, asnjë nga rekomandimet nuk ishte zbatuar plotësisht, përkatësisht tre ishin në proces të zbatimit dhe 13 nuk ishin trajtuar ende nga ana e menaxhmentit. Ndërkaq, në vitin 2015 ishin dhënë 17 rekomandime, prej të cilave dy rekomandime janë zbatuar; katër janë në proces të zbatimit dhe 11 nuk janë zbatuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Çështja 10 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Si rrjedhojë e menaxhimit jo efektiv të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve, menaxhmenti ka treguar regres në zbatimin e rekomandimeve pasi vetëm një pjesë e ulët e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët kanë filluar së zbatuari, derisa asnjë prej rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2016 nuk është zbatuar plotësisht. Menaxhmenti i komunës nuk aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Mos zbatimi në tërësi i rekomandimeve, tregon se kontrollet menaxheriale në komunë ende janë të pamjaftueshme. Prandaj, kjo situatë ka rezultuar në:

- Cilësinë e dobët të raportimit të brendshëm dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë;
- Llogaridhënie e dobët; dhe
- Dobësi në menaxhimin e proceseve operative, përfshirë menaxhimin e pasurive, zbatimin e procedurave të prokurimit, ekzekutimin e dobët të shpenzimeve kapitale dhe atyre për mallra dhe shërbime, mos zbatimin e rregullave të shërbimit civil dhe Ligjit të punës, menaxhim të dobët në ndarjen e subvencioneve, si dhe mos efikasitet në arkëtimin dhe menaxhimin e të hyrave.

Rekomandimi 10 Kryetari, duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha Organizatat Buxhetore, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Niveli i qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial është i dobët dhe sfidues. Përgjigja ndaj rekomandimeve të auditimit ende është jo efektive. Operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk është vendosur, pasi Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe Komiteti i Auditimit (KA) nuk janë themeluar.

Komuna, nuk kishte përmbushë as kërkesën e MF-së lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vet-vlerësimit. Organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj. Komuna, nuk i posedon asnjërën nga këto plane/strategji.

Gjithashtu, edhe në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosur ekzistencën e disa dobësive në menaxhimin e buxhetit/shpenzimeve, siç janë përmendur në brendi të këtij raporti.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Organizatat buxhetore janë të obliguara që të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e saj t'i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Një sistem i mirëfilltë i auditimit të brendshëm i ndihmon menaxhmentit në identifikimin e dobësive në menaxhimin financiar dhe kontrolleve të komunës. Kjo kontribuon në përmirësimin e kontrolleve të brendshme, arritjen e objektivave dhe përmirësimin e shërbimeve që ofron komuna.

Çështja 11 - Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

E gjetura Përkundër rekomandimeve tona të përsëritura, komuna ende nuk ka arritur që të siguroj shërbimet e auditimit të brendshëm brenda komunës ose të sigurojë mbulimin e tyre nga ndonjë organizatë tjetër buxhetore. Kjo, për shkak se menaxhmenti i komunës nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur auditimit të brendshëm dhe përmirësimin të aktiviteteve të kontrollit të brendshëm të komunës.

Rreziku Mungesa e aktiviteteve të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje që t'i identifikojë dobësitë e kontrolleve dhe të reagojë me kohë për eliminimin e tyre.

Rekomandimi 11 Kryetari, duhet të themeloj NjAB-në, me qëllim për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe e cila do të ndihmonte aktivitetet operative në vazhdim. Përveç kësaj ne sugjerojmë edhe themelimin/funksionimin e KA-së, që t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër të vogël kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe efikase ndaj problemeve operative të identifikuara.

Komuna, ende nuk e ka vendosur një sistem formal dhe efektiv të raportimit menaxherial. Forma dhe cilësia e raportimit të brendshëm aktual si të tilla nuk sigurojnë bazë për mbikëqyrje sistematike të aktiviteteve operative dhe variancave buxhetore.

Mungesa e një sistemi të kontrolleve për të siguruar pajtueshmëri të plotë me procedurat dhe kërkesat legislative mund ta ballafaqojë komunën me sfida afatgjate dhe humbje financiare.

Prolongimi i veprimeve efektive të menaxhmentit për të siguruar pajtueshmërinë e kërkuar rezulton me shmangie të komunës nga rezultatet dhe objektivat e përcaktuara, vlerë të ulët për para dhe shërbime të dobëta për qytetarët dhe shfrytëzuesit e tjerë.

Çështja 12 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Menaxhimi jo i duhur i proceseve në realizimin e buxhetit, ka ndikuar mangësi në ekzekutimin e buxhetit dhe atë në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Projektet kapitale të filluara me vonesë, si pasojë e vlerësimit të dobët të nevojave dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme, kanë ndikuar që dobësitë të mos trajtohen me kohë dhe në mënyrën e duhur. Si rezultat i kësaj, disa prej projekteve janë vonuar apo edhe nuk janë kryer fare derisa janë kryer pagesa për to. Më tutje, menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative. Komuna, gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive.

Rreziku Kërkesat e llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së pamjaftueshme, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta dhe shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 12 Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit për projekte kapitale, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.5. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për paraqitjen e gabimeve të përhapura në PFV që kanë rezultuar me modifikim të opinionit. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në PFV-të e vitit 2016 dhe për të siguruar një regjistrim dhe shpalesje të plotë dhe të saktë të pasurive komunale.	Po		
1.5. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse ndaj draft PFV janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme dhe janë nënshkruar edhe nga Kryetari i Komunës.		Gabimet në PFV janë evituar, por ka çështje tjera në lidhje me pagesat e gabuara të shpenzimeve si dhe mos shpalesja e plotë e pasurive dhe obligimeve.	
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili përcakton saktë veprimet dhe afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Një proces i vazhdueshëm i monitorimit, gjithashtu, duhet të jetë pjesë përbërëse e këtij procesi.		Komuna kishte përgatitur një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte shumë i ulët.	

2.4 Lista Kontrolluese e vet-vlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë që lista kontrolluese e vetvlerësimit për vitin 2016 do të plotësohet dhe dorëzohet në MF. Para dorëzimit në MF ajo duhet të rishikohet dhe përgjigjet e ofruara të konfirmohen. Kryetari duhet të iniciojë gjithashtu aktivitetet për përgatitjen e një strategjie komunale e cila duhet të jetë e gatshme për zbatim nga viti 2017. Kjo strategji duhet të shoqërohet me një kosto që përkon me burimet komunale dhe me mekanizma efektiv që sigurojnë zbatimin e saj dhe arritjen e rezultateve.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Aranzhimet e llogaridhënies	Kryetari duhet t'i analizojë arsyet e ngecjes së procesit të konsolidimit të brendshëm të komunës dhe të sigurojë që dobësitë e identifikuar të adresohen brenda vitit vijues. Kryetari, në bashkëpunim me MF-në, duhet të aranzhoj një program trajnimi të zyrtarëve komunal për certifikimin e tyre në fushën e shpenzimeve, në mënyrë që procesi i shpenzimeve të menaxhohet nga vet Komuna.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se identifikimi, vlerësimi i rrezikut dhe masat për reduktimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, shqyrtohen në nivelet më të larta të menaxhmentit. Më tej, duhet të sigurohet se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës, i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta rreth menaxhimit të rreziqeve.			Nuk janë marrë masa.
2.5.3 Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të siguroj se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.			Nuk janë marrë masa.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet t'i shqyrtojë alternativat për të siguruar që aktivitetet operative dhe financiare i nënshtrohen auditimit të brendshëm që do të shërbente si një përkrahje e rëndësishme për menaxhmentin në arritjen e objektivave në mënyrë më efektive dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore. Krahas kësaj, Kryetari duhet të themelojë Komitetin e Auditimit i cili do t'i rishikonte në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Projektionet e të hyrave duhet bëhen në bazë të analizave të mirëfillta të burimeve potenciale. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final dhe në kërkesat buxhetore për periudhat e ardhshme.		Pjesërisht i zbatuar pasi komuna ka ende vështirësi me ekzekutimin e buxhetit në kategori të ndryshme.	
3.3 Prokurimi Dobësi sistematike në kontratat publike kornizë	Kryetari duhet t'i analizojë shkaqet pse nuk ishin plotësuar kërkesat e prokurimit dhe pse kanë ndodhur parregullsitë e identifikuara. Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet e prokurimit dhe të sigurojë që të gjitha proceset e prokurimit do të zhvillohen në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe që kontratat me operatorët do të jenë të qarta dhe të plota. Pagesat duhet të ekzekutohen vetëm atëherë kur konfirmohet që të gjitha punët dhe pozicionet janë kryer në përputhje me kontratën.			Nuk janë marrë masa.

3.4 Prokurimi Dobësi jo sistematike	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha shërbimet ku kërkohet procedurë e prokurimit do të kontraktohen vetëm përmes procedurave adekuate të prokurimit. Kontrollat e mbikëqyrjes së projekteve duhet të forcohen për të siguruar që të gjitha pagesat bëhen vetëm pas konfirmimit që punë janë kryer. Kryetari duhet të sigurojë ndarje të detyrave në proceset e prokurimit për të siguruar objektivitet të plotë të vlerësimeve të tenderëve. Njëkohësisht të gjitha shpenzimet duhet të paguhen nga kategoritë adekuate ekonomike për të parandaluar keq-klasifikimin e shpenzimeve.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi Shmangia e procedurave të prokurimit	Kryetari duhet të analizojë arsyeshmërinë e përdorimit të kuotimeve për blerjet e natyrës së njëjtë, me theks të veçantë në rastet kur për vlerën e përgjithshme parashihet procedurë të hapur. Kryetari duhet të forcojë kontrollat në planifikimin dhe realizimin e prokurimit duke siguruar që për shpenzimet e natyrës së njëjtë do të përdoren procedurat e hapura për të arritur vlerën më të lartë për parane e paguar.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha shërbimet lidhur shëndetin publik kryhen dhe paguhen vetëm në institutet e licencuara nga organet kompetente të Kosovës.	Po		
3.2.2 Kompensimet për Paga dhe mëditje	Kryetari duhet t'i analizojë shkaqet e vonesave në emërimin e zyrtarëve kyç për menaxhimin e personelit dhe të sigurojë që këto pozita do të plotësohen më së largu deri në fund të vitit 2016. Kryetari duhet të sigurojë që kontrollat për menaxhimin e stafit janë vendosur për të parandaluar gabimet potenciale dhe humbjet e mëtejme financiare të komunës.			Nuk janë marrë masa.

3.5.3 Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të sigurojë që një draft-rregullore për ndarjen e subvencioneve do të përgatitet deri në fund të vitit 2016 dhe t'i dorëzohet Kuvendit Komunal për aprovim. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Të hyrat	Kryetari duhet të iniciojë menjëherë hartimin e një rregulloreje për taksa, tarifa dhe ngarkesa dhe të njëjtën t'ia kalojë për miratim Kuvendit Komunal. Ne do të sugjeronim një bashkëpunim me komunat tjera që mund të shërbejnë si shembull i mirë në këtë fushë dhe të shfrytëzohen praktikrat e mira për të lehtësuar tërë procesin. Gjithashtu, Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha llojet e taksave dhe tatimeve në këtë rregullore të zbatohen si në komunat tjera të Kosovës. Ky proces duhet të monitorohet vazhdimisht nga ana e Kryetarit me qëllim që të zbatohen kërkesat ligjore.			Nuk janë marrë masa.
3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj një proces efektiv të regjistrimit të të gjitha pasurive, duke përcaktuar rolet kyçe, që në këtë proces mund të ketë Drejtoria e Kadastrit, duke mbledhur dhe raportuar të gjitha të dhënat mbi pronat në posedim të komunës. Më pas, një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim të pasurive të identifikuar dhe, pas rishikimit kritik nga ana e Kryetarit, një raport t'i dorëzohet zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në sistemin e SIMFK-së (moduli i pasurive). Gjithashtu, komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive duhet të krijohen çdo vit në kohë adekuate që të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme). Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen para se PVF-të e vitit 2016 të jenë dorëzuar në MF.		Pjesërisht është zbatuar pasi përkundër që blerjet e vitin paraprak dhe blerjet e vitit aktual (2017) ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë dhe shpalosur në PFV regjistri i pasurive është ende jo i plotë dhe i pa saktë. E-pasuria për pasuritë nën 1000€ ende nuk është duke u aplikuar dhe regjistri i stoqeve të materialit shpenzues nuk mbahet.	

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet e pagesave në avanc, menaxhimin e personelit dhe vlerësimin e saktë të pasurive. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcur i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike.		Komuna kishte përgatitur një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte shumë i ulët.	
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentës së MFK-së	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Më pas, duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.			Nuk janë marrë masa.
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të siguroj hartimin e një strategjie të përgjithshme zhvillimore, si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së rezultateve kundrejt objektivave dhe të vendos funksione efektive të mbikëqyrjes.			Nuk janë marrë masa.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda muajve në vijim.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të merr në konsiderim themelimin e NjAB-së i cili përmes një programi gjithëpërfshirës të punës do të inkorporonte rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe do të vlerësonte efektivitetin e kontrollit të brendshëm.			Nuk janë marrë masa.
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që është ndërmarrë një shqyrtim kritik në trajtimin e të hyrave dhe vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Më tej, komuna duhet të sigurojë zbatimin e ligjit për tatimin në pronë dhe të ndërtimit, i cili ka për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave minimale ligjore, dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.			Nuk janë marrë masa.
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e duhura për t'i adresuar si çështje urgjente çështjet e përmendura më lart, ashtu që komuna të ketë të vendosur strukturën organizative dhe që vendet kyçe të punë të plotësohen me personelin adekuat dhe të azhurnohen dosjet e personelit, në mënyrë që të sigurohet cilësi në menaxhimin e burimeve njerëzore.		Një pesë e dosjes së personelit ka filluar të azhurnohet (sa i përket kontratave). Pjesa tjetër e rekomandimit mbetet për tu adresuar, përfshirë miratimin e Rregullores për strukturën organizative.	

3.1.3 Mallra dhe shërbime Dobësi në pranimin dhe shpërndarjen e mallrave	Kryetari duhet të vendosë kontrole të brendshme adekuate për të siguruar vlerën për paranë dhe ajo që është paguar të pranohet dhe të shfrytëzohet nga komuna, në mënyrë që shërbimet ndaj qytetarëve të përmirësohen. Më tutje, duhet të sigurohet që pasuria e blerë të regjistrohet në regjistrat e pasurive të komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.1.4 Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të sigurojë që një draft-rregullore për ndarjen e subvencioneve do të përgatitet deri në fund të vitit 2017, e cila do t'i dorëzohet Kuvendit Komunal për aprovim. Në këtë rregullore duhet të përcaktohen qartë kriteret për dhënien e subvencioneve dhe mekanizmat se si do të monitorohen dhe menaxhohen ato. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.1.5 Investimet Kapitale. Menaxhimi i kontratës dhe pagesave.	Kryetari duhet të siguroj mekanizma adekuate për menaxhim të projekteve komplekse dhe mbikëqyrje të pagesave për projektet të cilat ende nuk kanë filluar dhe të siguroj se projektet do të përfundohen sipas rregullave të parapara.			Nuk janë marrë masa.
3.1.5 Investimet Kapitale. Mos emërimi i menaxherit të projektit dhe mungesa e planit për menaxhimin e projekteve	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për gjetjet e auditimit për këto raste, ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse kanë ndodhur dështimet dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Kryetari duhet të ketë parasysh vlerën për paranë sidomos për projekte të kushtueshme kapitale. Më tutje, kryetari duhet të ndërmarr masa për eliminimin e këtyre dobësive pasi kontrata do të zgjas deri në vitin 2018. Për ndërtimin e rrugëve duhet të lidhen kontrata të veçanta për projektet konkrete.			Nuk janë marrë masa.

3.2 Pasuritë	Kryetari duhet të analizojë arsyet për mos regjistrimin e të gjitha pasurive në vitin 2016 dhe të atyre nga vitet paraprake. Kryetari duhet të sigurojë që puna e kryer nga komisioni për regjistrimin e pasurive do të monitorohet sistematikisht, dhe nëse kërkohet, do të ndërmerren veprime shitesë për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e vlerave të pasurive në PFV-të e vitit 2017 dhe më tutje. Përveç kësaj, procesi i regjistrimit të pasurive dhe pronave tjera të paregjistruara duhet të vazhdoj, dhe zyrtari për regjistrimin e pasurive duhet ta udhëheqë këtë proces. Gjithashtu, komisionet e inventarizimit duhet të kryejnë inventarizimin e gjithë pasurisë komunale. Më tutje, kryetari duhet të siguroj hartimin e një rregulloreje të brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare, përmes së cilës do të përcaktoj rregulla të qarta për mënyrën e përdorimit të automjeteve dhe evidentimit të shpenzimeve.		Pjesërisht është zbatuar pasi përkundër që blerjet e vitin paraprak dhe blerjet e vitit aktual (2017) ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë dhe shpalosur në PFV regjistri i pasurive është ende jo i plotë dhe i pa saktë. E-pasuria për pasuritë nën 1,000€ ende nuk është duke u aplikuar dhe regjistri i stoqeve të materialit shpenzues nuk mbahet.	
3.3 Obligimet e papaguara. Menaxhimi joadekuat i obligimeve	Kryetari duhet të forcojë kontrollet lidhur me pranimin e faturave dhe pagesën e tyre brenda afatit ligjor, për të siguruar që departamenti i financave do të krijojë një sistem efektiv dhe se të gjitha faturat e papaguara brenda afatit 30 ditësh të raportohen në mënyrë të saktë dhe plotë dhe si të tilla të shpalosen në PFV-të e komunës.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi

KOMUNA LEPOSAVIQ

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Leposaviqit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Zoran Todiq

Kryetar i Komunës së Leposaviqit,

Data: 29.05.2018., Leposaviq,